

## Albanisch

### Udhëzimet për mësim në gjuhën amtare (MGJA) për shkollat në zonën e zyrës së shkollës për rrethin Gütersloh

Gjendja: 01.11.2013

#### **1. Çka është MGJA dhe pse ofrohet ai?**

Mësimdhënia në gjuhën amtare është një ofertë shtesë e krijuar për nxënësit me një sfond emigrimi sipas mundësive buxhetore dhe organizative dhe nën mbikëqyrjen shtetërore të shkollave. Detyra e mësimi është, që në bazë të planprogramit aktual të ruhen dhe të zgjerohen aftësitë gjuhësore në shkrim dhe të folur dhe të përcjellen kompetenca të rëndësishme kulturore.

MGJA-ja zhvillohet nga mësuesit të cilët në vendlindjen e tyre kanë fituar një kualifikim mësimor në gjuhën për të cilën japin mësim ose një diplomë tjetër universitare në vendin e tyre. Mund të krijohen këto grupe për MGJA: në nivelin e ulët të shkollës fillore numri i fëmijëve të një gjuhe amtare të përbashkët duhet të jetë gjithmonë së paku 15 nxënës, në nivelin e lartë të shkollës fillore grupi duhet të përbëhet nga së paku 18 nxënës.

Për ofertën aktuale për mësim në gjuhën amtare, ju lutemi referojuni listës së bashkangjitur.

#### **2. Kush mund të merr pjesë në MGJA?**

Nëse ka një ofertë për mësimdhënie, çdo nxënës me një sfond migrimi mundet në parim të marrë pjesë në MGJA të gjuhës përkatëse të origjinës. Të përjashtuar janë nxënësit, të cilët nuk mund të ndjekin mësimin e rregullt duke marrë pjesë në MGJA.

#### **3. Si mund të bëhet regjistrimi për MGJA?**

Shkollat informojnë prindërit kur regjistrojnë fëmijët në shkollën fillore ose në një shkollë të mesme që nxënësit kanë mundësi të marrin pjesë në MGJA. Duhet të theksohet në veçanti se një regjistrim vlen në secilin rast deri në nivelin fillor, dmth. nga klasa e parë deri në klasë e katërt ose në nivelin e e lartë, domethënë për klasën e 5 deri në 9 ose 10. Regjistrimi nuk duhet të përsëritet çdo vit. Prindërit do të marrin nga shkolla një formular regjistrimi që do ta plotësojnë dhe kthejnë në shkollë. Shkolla e përcjell regjistrimin me vulën e shkollës më tutje në zyrën e shkollës.

Nëse Zyra e Shkollës pranon aplikacione nga shkollat në të cilat nuk është dhënë më parë mësim në gjuhën amtare, qeveria e rrethit duhet të vendosë nëse dhe si mund të zbatohen kërkesat plotësuese.

#### **4. Zbatimi i mësimdhënies**

Mësuesit e MGJA-së janë aktualisht të angazhuar në shkolla të ndryshme me mësimet e tyre javore të kontraktuara. Parimisht zhvillohet mësim për çdo grup nga tre orë në javë.

Për ndryshimet në orarin e mësimdhënies dhe të grupit të nxënësve duhet të raportohet menjëherë dhe këto mund të bëhen vetëm në konsultim me zyrën e shkollës. Mësuesit dërgojnë më 01.03. dhe më 31.10. çdo vit listën aktuale të nxënësve në zyrën e shkollës (kujtesa bëhet nga këtu).

## 5. Dëftesat

Për pjesëmarrje në MGJA, do të lëshohet nga mësuesi një vërtetim dhe do të dërgohet me kohë në shkollën fillore përkatëse të nxënësit për shkak të vënies së notës në dëftesë.

Vlerësimi në certifikatë parimisht do të shënohet në rubrikën **shënime** si më poshtë:  
"XXX ka marrë pjesë në mësim në gjuhën amtare \_\_\_\_\_. Suksesi i tij/saj vlerësohet me notën \_\_\_\_\_. (BASS [Përmbledhja zyrtare e e rregullave të shkollës] 13-63 nr.3/Nr. 6.4)".

Vlerësimi i suksesit **nuk** i dorëzohet nxënësit.

Në klasën 1 dhe 2, mësuesit informohen për një notë ose deklaratë mbi vlerësimin në secilën shkollë dhe i përshtatin rezultatet e performancës me këto rregullore.

## 6. Provimi i gjuhës

Nga nxënësit që kanë marrë pjesë rregullisht në MGJA (14-15 orë / niveli i ulët) kërkohet dhënja e një provimi të gjuhës në përputhje me § 5 (3) APO-SI në fund të kursit në arsimin e nivelit të ulët në nivelin e shkallës së dëshiruar. Pjesëmarrja në provim është e detyrueshme për të gjithë nxënësit. Provimi përfundimtar organizohet nga autoritetet e shkollës në zonën e rrethit qeveritar me marrëveshje.

Rezultati i provimit do të certifikohet në dëftesën e përfundimit. Nën "Suksesi" tregohet nota e provimeve dhe nën "Shënime" tregohet se nota bazohet në një provim të gjuhës pas pjesëmarrjes në MGJA dhe në cilën nivel të kërkesës është paraqitur (BASS 13-63 nr. 3 / nr. 6.3). Një dëftesë e veçantë nuk do t'i jepet nxënësit.

**Kur jepet dëftesa përfundimtare sipas §§ 38-40 APO-S mund të barazohet një notë e dobët në një gjuhë të huaj me së paku një notë të mirë në provimin e gjuhës!!!!**  
(BASS 13-63 nr.3 / nr 63)

## 7. Bashkëpunimi i shkollës me mësuesit e MGJA-së

Bashkëpunimi i ngushtë në mes të mësuesve të MGJA-së dhe drejtorisë së shkollës është patjetër i nevojshëm.

Shkolla e informon mësuesin me besueshmëri rreth ngjarjeve shkollore, ditëve pushimore lëvizëse, dëftesave dhe datave të konferencës, por edhe rreth p.sh. kur një nxënës është i sëmurë. Po ashtu, mësuesi mban evidencën, nëse një nxënës që nuk ka marrë pjesë në HSU nuk ka ndjekur edhe mësimet e rregullta. Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohet që të përjashtohet një mungesë e paarsyeshme nga mësimi.

Në shkollën e rregullt të mësuesve të MGJA-së, këta janë anëtarë të plotë të kolegjit.